

Kajtazi / agim.kajtazi@infopress-rh.com

Komandanti i KFOR-it, Erhard Bühler në Prizren

Bühler: "Kosova nuk është vend i kriminelëve dhe i krimit"

"Raporti i Dick Marty-it kundër Kosovës nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në raportin e Gjermanisë dhe Kosovës, mirëpo duhet të pranojmë se me të vërtetë po dëmtohet imazhi i Kosovës para së gjithash tek ata që lexojnë gazeta dhe nuk e njohin Kosovën", ka thënë komandanti i KFOR-it, Erhard Bühler

PRIZREN, 24 DEJANOR

Bashkim Susuri

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajori Erhard Bühler të martën në Prizren gjatë një vizite që i ka bërë gjimnazit "Loyola" me ç'rast është pritur nga drejtori Walter Happel ka thënë se raporti i Dick Marty-it kundër Kosovës nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në raportin e Gjermanisë dhe Kosovës, mirëpo duhet të pranojmë se me të

vërtetë po dëmtohet imazhi i Kosovës para së gjithash tek ata që lexojnë gazeta dhe nuk e njohin Kosovën. "Në aspektin afatgjatë nuk do të thotë asgjë, sepse Kosova ka përjetuar shumëçka tjetër, shumë gjëra më të këqija, pra kjo është e tejkaluar", ka thënë Bühler. Më tutje Bühler ka shtuar se ky raport nuk ka kurrfarë ndikimi në gjendjen në Kosovë. "Kosova është e qetë pas zgjedhjeve si kurrë më parë. Sa i përket raportit të Dick Marty-t, unë kam qëndrim dhe kam thënë edhe më herët se duhet të paraqiten dëshmi. Përdërisa nuk kemi dëshmi, atëherë të gjitha ato janë shpifje dhe individët të cilët akuzohen janë të pafajshëm deri në atë moment kur nuk kemi dëshmi", ka theksuar Bühler. "Raporti sigurisht se i ka shkaktuar dëm imazhit të Kosovës, por edhe ne sot këtu e pamë se Kosova është ndryshe. Vërtet duhet të punojmë edhe më tepër që ta përmirësojmë imazhin e Kosovës, se Kosova nuk është vend i kriminelëve dhe i krimit. Nëse janë bërë krime për këtë duhet të mer-



ren institucionet përkatëse. Unë kam besim të plotë se kjo do të ndodhë dhe në atë rast duhet të merren vendime të prera dhe të shpejta", është shprehur Bühler.

Situata stabile mundëson reduktimin e trupave të KFOR-it

Ndërkaq, duke folur për situatën në Kosovë ai ka thënë se ajo është stabile, andaj si e tillë mundëson reduktimin e trupave të KFOR-it që është duke u bërë. Duke dhënë detaje për ristrukturimin e forcave të KFOR-it në Ko-

sovë, Bühler ka thënë se në Kosovë do të mbeten dy Task Forca të stacionuara në perëndim dhe lindje dhe do të jenë mjaft mobile. "Njësitë e Task Forcës në Prizren do të bashkëngjitet me Task Forcën në Pejë. Të njëjtin rast e kemi pasur edhe në vitin 2004. Në muajin janar do të bëhet bashkimi i dy njësiteve (jug dhe perëndim), kurse Shtabi i Përgjithshëm do të jetë në Pejë. Në Prizren do të qëndrojnë akoma ushtarë, spitali ushtarak dhe njësitë e logjistikës, kështu që në Prizren do të jemi të përqendruar deri në fund të misionit", ka thënë Bühler.